



**VENDIM**

***Nr. 117 Datë 16.11.2011***

**MBI ANKANDIN MUJOR TË ALOKIMIT TË KAPACITETEVE TË  
INTERKONJEKSIONIT PËR MUAJIN DHJETOR 2011**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës 7, gërma “b” të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike” miratuar me VKM nr. 338, datë 19.03.2008 Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.11.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Kesh sh.a”, lidhur me alokimin e kapaciteteve për muajin dhjetor 2011

**Konstatoi se:**

KESH sh.a mund të përballlet me një situatë të përkeqësimit të kushteve hidroenergjitike për shkak të një thatësire të tejzgatur, cka do të vështirësonte mbulimin e nevojave me energji elektrike të konsumatoreve tarifore,

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Ankandi i alokimit të kapaciteteve të interkoneksionit për muajin dhjetor 2011, të kryhet vetëm për pjesën e mbetur të kapaciteteve pas sigurimit të nevojave të shoqërisë KESH sh.a në përputhje me kërkesën e paraqitur nga

kjo kompani për alokimin e kapaciteteve te interkonjeksionit per muajin dhjetor.

2. OST sh.a te siguroj alokimin e kapaciteteve te interkonjeksionit për muajin dhjetor për nevoja të KESH sh.a duke përfshirë edhe kapacitetet e pashfrytëzuara nga CEZ Shpërndarje nga të drejtat e siguruara.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë KESH sh.a dhe OST sh.a për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**